



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion, Mandate,

Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen

e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 25

Prishtinë, më 24.04.2018, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N/10

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Hajdar Beqa, Bahrim Shabani, Sami Kurteshi, Arben Gashi, Korab Sejdiu, Igor Simiq, Shkumbin Demaliaj dhe Bilall Sherifi.

Munguan: Glauk Konjufca dhe Nezir Cocaj.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Fitim Sadiku -POLIS, Sanije Berisha OBCE, Agnesa Haxhiu -KDI, Shefki Kastrati- NDI, Valbona Bytyqi –Ekonomia Online, Blerim Sallahu- GP VV, Rreze Hoxha -GLPS, Rinor Beka- NDI dhe Muhamet Shehu- Kosova Sot.

Mbledhjen e kryesoi, Hajdar Beqa, nënkryetar i komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit Funkcional në Projektligjin nr.06/L-012 për kryeqytetin e Republikës së Kosovës/Prishtinën;
3. Shqyrtimi i Raportit me amendamente për Projektligjin nr.06/L-009 për Ndërmjetësim;
4. Shqyrtimi i Raportit Vjetor i punës së Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas për vitin 2017;
5. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime

2. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit Funkcional në Projektligjin nr. 06/L-012 për kryeqytetin e Republikës së Kosovës/Prishtinën

Arben Gashi, duke iu referuar raportit, tha se amendamentet e propozuara janë në kundërshtim të plotë me Kushtetutën. Vërejtjet e paraqiti kryesisht në kompetencat për Kryeqytetin, ku tha se Ligji për Policinë e Kosovës parasheh në mënyrë eksplicite hierarkinë komanduese dhe përgjegjësitë, ndërsa me këtë amendament po krijohet një zinxhir tjetër jashtë atij komandues të policisë së Kosovës. Z. Gashi kishte edhe vërejtje të tjera me theks të veçantë tha se me këto propozime disbalancohet komplet sistemi, sepse nuk është e qartë se çka nënkupton polici e qytetit, si definohet, sa të punësuar do të ketë, si do të rekrutohen këta persona, pastaj kujt do t'i japin përgjegjësi, cila është hierarkia komanduese, shqetësim tjetër i ngritur nga deputeti Gashi ishte në atë se çka nëse kjo polici bie ndesh me komandën e drejtorisë së përgjithshme të policisë së Kosovës. Ai në fund tha se në këto probleme nuk po shihet zgjidhja, gjithashtu tha se këto probleme do të kenë pasoja, sidomos me shumicën etnike në Kosovë. Vërejtje kishte edhe në amendamentin 4 i cili flet për kujdesin dytësor shëndetësor. Qeverisja lokale është shumë më e komplikuar se sa është paraparë nga Komisioni Funkcional, prandaj shumica e amendamenteve janë në kundërshtim me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale dhe në kundërshtim me Kushtetutën e Kosovës dhe ky raport duhet t'i kthehet Komisionit Funkcional me vërejtjet e paraqitura, potencoi deputeti Arben Gashi.

Hajdar Beqa tha se pas shqyrtimit të Raportit të Komisionit të Administratës Publike, konsideroj se ajo që duhet të potencohet ka të bëjë me amendamentin, 2 paragrafi 4.2. Mendoj se është në kundërshtim me nenin 13 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, po ashtu ky amendament është në kundërshtim me qëllimin e projektligjit, sepse ky projektligj rregullon statutin dhe funksionimin e kryeqytetit. Për me tepër në asnjë dispozitë të projektligjit nuk është e përfshirë ndonjë normë që flet për Kryeqytetin Historik të Republikës së Kosovës, Prizrenin, dhe si i tillë nuk mund të përfshihet si normë brenda dispozitave të këtij projektligji. Në vazhdim tha se ky raport duhet t'i kthehet komisionit me vërejtjet e paraqitura, gjithashtu të ftohet komisioni përkatës dhe, të arsyetojë amendamentet. Megjithatë si ligj i veçantë duhet të ketë disa kompetenca të cilat nuk bien ndesh me Kushtetutën, theksoi z. Beqa.

Korab Sejdiu tha se është dashur të rregullohet nëpërmes procedurës së amendamentimit në Kuvend, por në asnjë mënyrë nuk është plotësuar ligji në nivelin sa ka qenë e nevojshme që të përmirësohet. Z. Sejdiu paraqiti vërejtje në amendamentin 2, pastaj çështja tjetër si shqetësim ishte krijimi i policisë ashtu si po parashihet në këtë projektligj. Ai tha se është e nevojshme që Prishtina të ketë polici të veçantë, por kjo duhet të bëhet përmes amendamentimit të Ligjit për Policinë, ku mund të përcaktohet edhe mbikëqyrja edhe zinxhiri komandues të cilit i përkasin. Çështja tjetër ishte lidhur me amendamentin 11, ku kryeqyteti cakton taksë shtesë për kryeqytetin, por nuk përcakton çka është kjo taksë apo pse është kjo taksë shtesë sepse kjo është ngarkesë për qytetarin, tha deputeti Korab Sejdiu.

Sami Kurteshi tha se të gjitha dilemat dhe shqetësimet që u ngritën nga parafolësit duhet të kenë një përgjigje. Z. Kurteshi tha se amendamenti 3 neni 7, i propozuar duhet të diskutohet. Ndërsa pika 1.1.6 nuk është e sqaruar deri në fund sa i përket organizimit, kjo duhet rregulluar më hollësisht me akt nënligjor. Për amendamentin 11 që flet për taksën për kryeqytetin, deputeti Kurteshi tha se kjo taksë duhet të jetë e pranueshme për qytetarët që mos të rëndohet qytetari, por megjithatë edhe ky amendament ka nevojë për sqarim. Ndërsa sa i përket amendamentit 4, për kompetencat për afrimin e përkujdesit shëndetësor, ai tha se kjo duhet të jetë në frymën e spitaleve rajonale. z. Kurteshi u pajtua që në komision të ftohet kryetari i Komisionit Funkcional në mënyrë që të sqarohet para komisionit propozimet.

Shkumbin Demaliaj tha se pajtohet me vërejtjet e parashtruara nga parafolësit. Propozim i deputetit Demaliaj ishte që raporti t'i kthehet komisionit Funkcional në mënyrë që të shqyrtohen edhe njëherë dhe mos të krijohet kolizion kompetencash në lidhje me këtë çështje.

Bilall Sherifi tha nuk ka çfarë të shtohet me tepër vetëm se duhet të dihet se ku është marrë modeli i tillë nga hartuesit apo propozuesit e këtyre amendamenteve. Këto amendamente nuk janë në harmoni me legjislacionin në fuqi, por as me rregullimin kushtetues edhe atë ligjor. Ai propozoi që ligji të mbetet ashtu siç ka qenë ose t'i kthehet komisionit pa rekomandim të komisionit.

Hajdar Beqa tha se pajtohem të gjithë që është i domosdoshëm Ligji për Kryeqytetin, por megjithatë ai propozoi që amendamenti 2, paragrafi 4.2, përveç që është në kundërshtim me Kushtetutën, është edhe në kundërshtim edhe me qëllimin e Ligjit dhe si i tillë duhet të hiqet nëse përkrahet nga komisioni, ndërsa të gjitha amendamentet e tjera me vërejtjet e paraqitura t'i kthehen për shqyrtim Komisionit Funkcional që të japë sqarim.

Meqë nuk kishte diskutime të tjera komisioni vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

Rekomandim

Komisioni nuk përkrah raportin me amendamente në Projektligjin nr. 06/L-012 për Kryeqytetin e Republikës së Kosovës/Prishtinën.

3. Shqyrtimi i Raportit me amendamente për Projektligjin nr.06/L-009 për Ndërmjetësim

Në mungesë të kryesuesit të Grupit Punues, z. Nezir Çoçaj, raportin me amendamente për Projektligjin për Ndërmjetësim para komisionit e paraqiti deputeti Hajdar Beqa. Ai tha se për këtë projektligj grupi punues ka paraqitur 32 amendamente. Pas diskutimeve u propozua që nga raporti të hiqen amendamenti 29 dhe 30.

Meqë nuk pati diskutime të tjera, kryesuesi konstatoi se me tre vota “për” të hiqen amendamentet 29 dhe 30, ndërsa me dy vota “për” dhe një “abstenim” u vendos që këto dy amendamente të mbesin në raport, komisioni nxori këtë:

Rekomandim

I. Miratohet Raporti me amendamente i komisionit;

II. Projektligjin nr. 06/L- 009 për Ndërmjetësim dhe amendamentet e propozuara, procedohen për shqyrtim sipas kompetencës në komisionet kryesore;

III. Amendamentet e miratuara dhe të pa përkrahura nga komisioni, janë paraqitur si aneks i këtij procesverbali.

4. Shqyrtimi i Raportit Vjetor i punës së Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas për vitin 2017

Ramadan Gashi tha se Agjencia për Ndihmë Juridike Falas tani me rihapjen e zyrave rajonale për Ndihmë Juridike Falas në komunën e Ferizajt dhe të Gjakovës ANJF ka përmblush shtrirjen rajonale në shtatë qendrat më të mëdha të Kosovës, por nuk ka përmblushur në mënyrë të plotë nenin 22 të Ligjit për Ndihmë Juridike Falas, ku për të bërë mbulueshmëri të plotë në tërë territorin e Kosovës, parashihet hapja e zyrave mobile në të gjitha komunat e Kosovës.

Z. Gashi më tej shtoi duke thënë se edhe përkundër nevojës kërkesa buxhetore e ANJF-së asnjëherë nuk ka hasur në përkrahje dhe se konsiderohet se mos hapja e këtyre zyrave paraqet situatën ku të gjithë qytetarët e Kosovës nuk kanë mundësi të barabartë të realizojnë të drejtën për t'ju qasur në mënyrë efikase sistemit të drejtësisë për shkak të mungesës së mjeteve financiare. Z. Gashi me theks të veçantë përmendi bashkëpunimin e ANJF-së me institucione ndërkombëtare, me theks të veçantë me UNDP, sidomos rolin që ka pasur kjo e fundit në ngritjen e vetëdijesimit të qytetarëve për shërbimet të cilat afrohen në Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas. Më tej tha se ANJF gjatë vitit 2017 është përkrahur nga UNDP edhe me organizimin e një punëtorie me stafin e ANJF-së ku është diskutuar lidhur me realizimin dhe implementimin e planit strategjik 2015-2019 dhe prioritetet e ANJF-së për vitin 2018. ANJF-ja përmes mekanizmave të saj ka afruar ndihmë juridike falas, në katër fusha kryesore; në fushën penale, civile, kundërvajtje dhe në fushën administrative. Z. Gashi theksoi se për shkak të buxhetit të limituar që kemi në lëmin penale, ne afrojmë ndihmën juridike falas deri në momentin kur paraqitet nevoja për përfaqësim në gjykata, duke pohuar se Këshilli Gjyqësor i Kosovës në ndihmë juridike falas sipas detyrës zyrtare bën angazhimin e avokatëve për veprat penale, kurse në bazë të Ligjit për Ndihmë Juridike Falas, ne jemi të obliguar të angazhojmë avokat edhe për kategori tjera që kanë dënime më të vogla, por që i plotësojnë kriteret e ligjit për Ndihmë Juridike Falas. Ai potencoi se me kompletimin e shtatë zyrave këtë vit janë trajtuar 300 raste më shumë se në vitin e kaluar, ndërsa në tre mujorin e parë të këtij viti agjencia ka pasur 1200 raste. Në fund si sfidë, u tha se mbetet sigurimi i buxhetit të qëndrueshëm për të plotësuar nevojat e qytetarëve edhe në lëmin penale, sigurimi i ANJF-së në objekte publike në mënyrë që me mjetet e qirasë të paguhen avokatët për lëmi të caktuar, sfidë tjetër u tha se është edhe shtrirja e drejtë dhe e barabartë e ANJF-së në të gjitha rajonet, përkatësisht në të gjitha komunat e Kosovës,

sensibilizimi dhe vetëdijesimi i publikut, veçmas i grupeve të interesit, për shërbimet që ju afron ANJF, si dhe implementimi efektiv i planit strategjik 2015-2019.

Hajdar Beqa, pyetjet e drejtuara për drejtorin e Agjencisë ishin; sa funksionojnë dy zyrat e rihapura në Ferizaj dhe Gjakovë, sa është ndryshuar gjendja në raport me vitin e kaluar në lidhje me mungesën e buxhetit për përfaqësimin në fushën penale, a ka bërë agjencia ndonjë vlerësim se si është raporti në mes numrit të rasteve të përfaqësuara dhe vendosja e tyre në favor të palës dhe pyetja e fundit si “bëhet angazhimi i avokateve kur kjo e drejtë i takon palës?

Ramadan Gashi duke iu referuar pyetjeve të deputetit Hajdar Beqa ai tha se zyrat në Ferizaj dhe në Gjakovë funksionojnë mirë, ndërsa sa i përket angazhimit të avokatëve në fushën penale ai tha se është e njëjta situatë.

Sami Kurteshi tha se duke qenë se e njeh agjencinë shumë moti, dhe duke qenë se është një agjenci shume i rëndësishëm më ka shqetësuar trajtimi institucional i kësaj agjencie sepse është e vetmja agjenci që afron ndihmë juridike falas. Numri i njerëzve që kanë nevojë për ndihmë juridike falas është shumë më i madh sesa numri i njerëzve që na del në statistika. Pyetjet e parashtruara nga deputeti Sami Kurteshi kishin të bëjnë me dallimin e madh të lëndëve në qytete të ndryshme, pastaj mungesa e bashkëpunimit me Avokatin e Popullit? Z. Kurteshi u interesua edhe për mbrojtjen nga Oda e Avokatëve duke bërë pyetje se “pse nuk është e rregulluar kjo çështje, ndërsa tha se do te angazhohet personalisht për të ndihmuar Agjencinë për Ndihme Juridike Falas, por gjithashtu kërkoi nga drejtori që të paraqesë në kuvend nevojat që ka kjo agjenci.

Ramadan Gashi tha se sa i përket Avokatit të Popullit, mendoj që duhet të ketë më shumë bashkëpunim. Ndërsa sa i përket bashkëpunimit me Odën e Avokateve ai tha se agjencia ka bashkëpunim me këtë odë në lidhje me angazhimin e avokateve, gjithashtu tha lista e avokatëve vjen nga oda dhe angazhimi nga agjencia bëhet me radhë, theksoi z. Gashi.

Igor Simiq tha se numri i të punësuarve është shumë i vogël, në krahasim me numrin e komunave të cilat i mbulonin, nga numri i madh i lëndëve me të cilat është marrë kjo agjenci vetëm 15 raste janë të serbëve që kanë kërkuar nga ju ndihmë juridike. Meqenëse në raport është dhënë numri i të punësuarve, ku prej tyre janë 23 shqiptarë, 1 ashkali, 1 turk dhe 1 boshnjakë, pse kjo agjenci nuk ka një përfaqësues të komunitetit serb të punësuar?

Ramadan Gashi duke u përgjigjur në pyetjen e parashtruar nga deputeti Simiq tha se me projektin e UNDP-së agjencia ka pasur zyrën në Mitrovicë, në pjesën veriore dhe në pjesën jugore, në pjesën veriore kanë qenë të punësuar vetëm pjesëtarë nga komuniteti serb, ndërsa në zyrën në Graçanicë agjencia ka pasur të punësuar një serb, por këto zyre tani janë mbyllur theksoi z. Gashi. Ai potencoi faktin se në konkurset e hapura nga agjencia nuk ka pasur interesim nga komuniteti serb. Ndërsa në pyetjen sa kërkohet ndihma juridike nga serbët, ai tha se kërkohet, por në masë të vogël.

Pas diskutimeve Komisioni miratoi Raportin e Punës së Agjencisë për Ndihme Juridike falas dhe vendosi që Kuvendit t’ia paraqesë këtë:

REKOMANDIM

Të miratohet Raporti i Punës së Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas për vitin 2017

5. Të ndryshme.

Në këtë pikë të rendit të ditës nuk kishte diskutime.

Mbledhja përfundoi në orën 13:48

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisionit.

Nënkryetar i komisionit,

Hajdar Beqa

Aneks- Amendamentet e propozuara në Projektligjin nr. 06/L-009 për Ndërmjetësim;

Amendamenti 1

Neni 2 i Projektligjit, paragrafi 2 riformulohet si vijon:

“2. Ndërmjetësimi në fushën penale zbatohet në rastet ku parashihet dënimi me gjobë dhe dënimi me burgim deri në 3 vjet, përveç rasteve të parapara në paragrafin 3 të këtij neni.”

Amendamenti 2

Neni 3, paragrafi 1.3 riformulohet si vijon:

1.3. Referent për ndërmjetësim, nënkupton zyrtarin e gjykatës apo atë të prokurorisë themelore. Zyrtarin e gjykatës që administron me rastet e referuara për ndërmjetësim nga gjykata dhe organet administrative, si dhe zyrtarin e prokurorisë që administron me rastet e referuara nga prokuroria. Referenti për ndërmjetësim mundet t’ i asistojë palët me rastet e vetë inicimit.

Amendamenti 3

Neni 3, paragrafi 1.4 riformulohet si vijon:

Ndërmjetësuesi, është personi i tretë, i paanshëm, i licencuar nga Ministria e Drejtësisë, i cili është përzgjedh të ndërmjetësojë në mes palëve me qëllim të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, në pajtim me parimet e ndërmjetësimit.

Amendamenti 4

Neni 3 i Projektligjit, pas nënparagrafit 1.5 shtohen nënparagrafët e rinj si vijon:

1.6. Marrëveshja e ndërmjetësimit, është marrëveshje e arritur me shkrim e nënshkruar nga palët dhe ndërmjetësuesi për zgjidhjen e kontestit ndërmjet palëve në procedurën e ndërmjetësimit. Pa marrë parasysh mënyrën e referimit të rastit marrëveshja e ndërmjetësimit ka fuqinë e titullit ekzekutiv - përmbarues dhe është i detyrueshëm për palët.

1.7. Oda e Ndërmjetësuesve, është person juridik i pavarur jofitimprurës, që vepron në pajtim me këtë ligj dhe statutin e saj të miratuar nga Kuvendi i Përgjithshëm i Odës së Ndërmjetësuesve dhe të aprovuar nga Ministria e Drejtësisë.

1.8 Hapësirë pune, zyrë apo ambient i përshtatshëm për zhvillimin e seancave të ndërmjetësimit sipas parimeve të ndërmjetësimit, e cila do të jetë në kuadër të gjykatës, prokurorisë apo lokacion tjetër të caktuar nga Oda e Ndërmjetësuesve, duke marrë në konsideratë vullnetin e palëve.

1.9 Regjistri, është regjistri i ndërmjetësuesve të Licencuar nga Ministria e Drejtësisë.

Amendamenti 5

Neni 9, paragrafi 1 në rreshtin tetë dhe nëntë fjalët “kërkesëpadiisë, detyrohet të informojë dhe udhëzojë palët në procedure e ndërmjetësimit.” **Zëvendësohen** me fjalët “padiisë, duhet të informojë dhe obligojë palët në procedurën e ndërmjetësimit.”

Amendamenti 6

Neni 9 i Projektligjit, paragrafi 3 fjalët “zgjidhur mosmarrëveshjen e tyre” zëvendësohen me fjalët “**provuar fillimin e ndërmjetësimit,**” dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Amendamenti 7

Neni 9, paragrafi 4 riformulohet si vijon: “4. Palët mund të mos vazhdojnë me procedurën e ndërmjetësimit dhe mund të kthehen në procedurën gjyqësore, jo më gjatë se 30 ditë.”

Amendamenti 8

Neni 10, paragrafi 1 në rreshtin e katërt fjalët “lista e” zëvendësohen me fjalët “regjistri i” dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Amendamenti 9

Neni 10, paragrafi 4, fjalët “ me radhë në mënyrë alfabetike” zëvendësohen me fjalët “ **sipas radhës së rajonit që mbulon gjykata apo prokuroria**”

Amendamenti 10

Neni 11 i Projektligjit, paragrafi 3 në rreshtin e tretë pas fjalës “personalisht” shtohen fjalët “ përmes teknologjisë apo përfaqësimit me pëlqim të palëve, ” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 11

Neni 11 i Projektligjit, paragrafi 4 bartet si paragrafi 1, kurse paragrafi 1 bëhet 2 dhe renditja e paragrafëve dhe nën paragrafëve bëhet sipas radhës.

Amendamenti 12

Neni 12 i Projektligjit paragrafi 1 riformulohet si vijon:

“1. Në rast se palët pajtohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen e tyre përmes ndërmjetësimit, referenti për ndërmjetësim e informon organin iniciues, duke ia dorëzuar një kopje të marrëveshjes së nënshkruar për fillimin e procedurës së ndërmjetësimit, me ç’ rast organi iniciues do të pezullojë procedurën, deri sa të kalojë afati i ndërmjetësimit.”

Amendamenti 13

Neni 12 i Projektligjit, paragrafi 8 riformulohet dhe bartet pas paragrafit 5 të këtij nenin me përmbajtjen si vijon:

“6. Në qoftë se ndërmjetësuesi vlerëson se do të ishte në dobi të procedurës së ndërmjetësimit, ai mund të zhvillojë takime të ndara me qëllim të gjetjes së alternativave për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, por jo edhe vetë zgjidhjen.”

Renditja e paragrafëve në vazhdim bëhet sipas numrave me radhë.

Amendamenti 14

Neni 13 i Projektligjit, paragrafi 1 në rreshtin e nëntë pas fjalës “të iniciojnë” shtohen fjalët “ dhe vazhdojnë” dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Amendamenti 15

Neni 14, paragrafi 4 në rreshtin e tret fjalë “fushëveprimin” zëvendësohet me fjalën “objektin” dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Amendamenti 16

Neni 14, paragrafi 5 pas fjalës “ detyrimeve” shtohen fjalët “ dhe e përshtatshme për përmbartim.”

Amendamenti 17

Neni 15 i Projektligjit, paragrafi 2 në fund të fjalisë fjalët “ dokument përmbartues” zëvendësohen me fjalët “ vendimit të formës së prerë. ”

Neni 15, paragrafit 4 riformulohet si vijon:

“4. Nëse Ndërmjetësimi fillon me vetë inicimin e palëve, marrëveshja e arritur me shkrim e nënshkruar nga palët dhe ndërmjetësuesi, e cila përmban klauzolën (vërtetimin) mbi plotfuqishmërinë dhe ekzekutueshmërinë e marrëveshjes, ka fuqinë e dokumentit përmbartues në përputhje me ligjin përkatës për procedurën përmbartimore.”

Amendamenti 18

Neni 16 i Projektligjit, paragrafi 2 **hiqet** dhe renditja e paragrafëve në vazhdim bëhet sipas numrave me radhë.

Amendamenti 19

Neni 16 i Projektligjit, paragrafi 3 në rreshtin e tretë hiqet referenca “ dhe 2 “ dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Amendamenti 20

Neni 17 paragrafi 5 në rreshtin e katërt pas fjalës “në fuqi “ shtohet lidhëza “dhe” pjesa tjetër mbetet si në Projektligj.

Amendamenti 21

Neni 18 i Projektligjit, pas paragrafit 2 shtohet paragrafi i ri 3 me përmbajtjen si vijon:

“3. Ndërmjetësuesi nuk mund të angazhohet për asnjërën palë në të njëjtën mosmarrëveshje apo kontest ku ai ka ndërmjetësuar, qoftë gjatë apo pas përfundimit të procedurës së ndërmjetësimit.”

Amendamenti 22

Neni 19, paragrafi 1 në rreshtin e tretë fjala “nuk” **hiqet** dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Amendamenti 23

Neni 19, paragrafi 2, riformulohet si vijon:

“2. Tarifa për ndërmjetësuesin do të rregullohet me akt nënligjor, të cilin e nxjerr Ministria e Drejtësisë dhe do të jenë ekuivalente apo të përafërta me tarifat e shërbimeve që afrohen në kuadër të profesioneve të tjera të lira.”

Amendamenti 24

Neni 20, i Projektligjit, riformulohet si vijon:

“ Neni 20

Aftësimi Profesional

1. Ministria e Drejtësisë është përgjegjëse për përcaktimin e politikave zhvillimore lidhur me fushën e ndërmjetësimit, mbikëqyrjen dhe shqiptimin e masave disiplinore që rrjedhin nga Kodi i Mirësjelljes.
2. Ndërmjetësuesit janë të obliguar që t’i ndjekin në mënyrë të vazhdueshme trajnimet për t’u pasuruar me njohuri të reja për ushtrimin e ndërmjetësimit në pajtim me legjislacionin në fuqi, aktet e përgjithshme dhe programin e trajnimeve të përgatitura nga Ministria e Drejtësisë.
3. Ministria e Drejtësisë angazhohet në organizimin e kampanjave të ndryshme me qëllim të informimit të publikut për mundësitë e shfrytëzimit të ndërmjetësimit, si dhe në promovimin e procesit të ndërmjetësimit.

Amendamenti 25

Titulli i Kapitullit IV riformulohet si vijon: “ODA NDERMJETËSUESVE, NDERMJETËSUESI DHE REGJISTRI”

Amendamenti 26

Pas nenit 20 të Projektligjit shtohet nen i ri me përmbajtjen si vijon:”

Neni 21

Oda e Ndërmjetësuesve

1. Oda e Ndërmjetësuesve është person juridik i pavarur jofitimprurës, që vepron në pajtim me këtë ligj dhe statutin e saj të miratuar nga Kuvendi i Përgjithshëm i Odës së Ndërmjetësuesve dhe të aprovuar nga Ministria e Drejtësisë.

2. Mënyra e organizimit dhe funksionimit rregullohet me akt të brendshëm të Odës. “

Renditja e neneve në vazhdim bëhet sipas numrave me radhë.

Amendamenti 27

Neni 21, paragrafi 1 i projektligjit **hiqet** dhe renditja e paragrafëve në vazhdim bëhet sipas numrave me radhë.

Amendamenti 28

Neni 21, paragrafi 2 i Projektligjit riformulohet si vijon: “1. Ndërmjetësues mund të jetë çdo person i cili i plotëson kushtet:

” Rënditja e neneve dhe paragrafëve në vazhdim bëhet sipas numrave me radhë.

Amendamenti 29

Neni 22 i Projektligjit, paragrafi 1 pas fjalës “*Drejtësisë*” shtohet teksti “*dhe Oda e Ndërmjetësuesve*”, teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 30

Neni 25 i Projektligjit në rreshtin e pestë pas fjalës “ Penal të “shtohen fjalët “ Republikës së “ dhe teksti vazhdon si në projektligj.